



Programi i lëndës “Farmakognozi”	
Lëmi	Shëndetësi
Profili	Farmacii
Niveli	I
Klasa	Klasa 11
Fondi i orëve të lëndës:	35 javë x 1 orë/javë = 35 orë
Programi i hollësishëm i lëndës	
Kapitulli I: Historiku i farmakognozisë	
a) Qëllimet e kapitullit	
Në përfundim të kapitullit nxënësit duhet të: <ul style="list-style-type: none">- përkufizojnë etapat e zhvillimit të farmakognozisë- përshkruajnë objektin e studimit, detyrat aktuale dhe perspektivën e saj.- tregojnë për lidhjen e farmakognozisë me shkencat tjera.	
b) Temat e kapitullit	
<ul style="list-style-type: none">- Hyrje në farmakognozi.- Farmakognozia gjatë epokave të zhvillimit të shoqërisë.- Etapat e zhvillimit të farmakognozisë ndër vite.- Objekti i farmakognozisë dhe detyrat aktuale dhe perspektiva e saj.- Lidhja e farmakognozisë me shkencat tjera.	
c) Udhëzime didaktike për kapitullin	
Rekomandohet që mësuesi të: <ul style="list-style-type: none">- ilustron ligjëratat me shembuj të ndryshëm nga jeta e përditshme;- ilustron ligjëratat edhe me sllajde dhe revista që kanë të bëjnë me bimët- vlerësojë nxënësit me detyra kontrolli.	
d) Kushtet për realizimin e kapitullit	
<ul style="list-style-type: none">- Videoprojektorë,- CD-programe- atlase gjeografike, vizatime dhe herbariume	
Kapitulli II: Burimet e përfitimit të drogave mjekësore	
a) Qëllimet e kapitullit	
Në përfundim të kapitullit nxënësit duhet të: <ul style="list-style-type: none">- shpjegojnë origjinën e drogave mjekësore;- dallojnë zonat fitoklimatike të vendit ku mbidhen drogat mjekësore;- rendisin epërsitë dhe te metat e mbledhjes së bimëve të egra mjekësore;- përshkruajnë rrethanat që diktojnë kultivimin e bimëve mjekësore;- ilustron faktorët kryesorë që ndikojnë në shtimin dhe zhvillimin e bimës;- tregojnë për faktorët klimatikë dhe ndikimin e tyre në bimët mjekësore;- përshkruajnë rregullat e mbledhjes së bimëve mjekësore;- demonstrojnë përgatitjen e materialit të mbledhur, për përpunim ose për tharje;- shpjegojnë procesin dhe meetodat e tharjes së drogave mjekësore;	

<ul style="list-style-type: none"> - interpretojnë ambalazhimin dhe depozitimin e drogave mjekësore;
<p>b) Temat e kapitullit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfitimi i drogave bimore - Zonat fitoklimatike dhe bimësia mjekësore - Bimët e kultivuara dhe rrethanat që diktojnë kultivimin e bimëve mjekësore, epërsitë dhe të metat e kultivimit. - Rrugët e shtimit të bimëve mjekësore - Kushtet klimaterike dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e bimës - Kushtet tokësore si faktorë të rëndësishëm - Faktorët gjeografikë bimorë - Mbledhja, ruajtja dhe standardizimi i bimëve mjekësore - Procesi i mbledhjes, pjesët që mbliidhen, koha e mbledhjes, rregullat që respektohen gjatë mbledhjes. - Mbledhja e organeve bimore-organet nëntokësore, lëvoret, drurët, sythat, gjethet, barnat, lulet, frytet dhe farat. - Metodatat e tharjes së drogave bimore - Mënyrat e ambalazhimit të drogave bimore.
<p>c) Udhëzime didaktike për kapitullin</p> <p>Rekomandohet që mësuesi të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - organizojë vizitë në kopshtin botanik; - ilustrtojë me anë të vizatimeve sa është e mundur temat e kapitullit; - nxitë aftësitë dalluese të nxënësve me anë të pyetjeve gojore; - organizojë test me shkrim;
<p>d) Kushtet për realizimin e kapitullit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Videoprojektorë, vizatime - CD-programe - atlase, skica, herbariume, foto nga interneti
<p>Kapitulli III: Esencat dhe drogat përkatëse</p>
<p>a) Qëllimet e kapitullit</p> <p>Në përfundim të kapitullit nxënësi duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përkufizojnë esencat dhe drogat esenciale; - tregojnë përhapjen dhe lokalizimin e drogave esenciale; - shpjegojnë për procesin e prodhimit të drogave esenciale; - përshkruajnë hapat metodikë të përgatitjes së lëndës së parë për përpunim; - shpjegojnë metodat e ekstraktimit të drogave bimore-macerimi, ekstraktimi, distilimi; - përshkruajnë përbërjen kimike të esencave bimore; - dallojnë drogat e pasura me esenca;
<p>b) Temat e kapitullit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri të përgjithshme për esencat. - Procesi i formimit të esencave në drogat bimore. - Roli dhe rëndësia e esencave në drogë. - Rrugët e përfitimit të esencave. - Metodatat e nxjerrjes së esencave me macerim. - Metodatat e nxjerrjes së esencave me ekstraktim. - Metodatat e nxjerrjes së esencave me distilim. - Karakteristikat fizike të esencave. - Përbërja kimike e esencave.

<ul style="list-style-type: none"> - Analiza e drogave me esenca. - Drogat e pasura me esenca- hidrokarburet dhe derivatet e oksigjenuara të tyre.
c) Udhëzime didaktike për kapitullin
<p>Rekomandohet që mësuesi të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - krijojë mundësinë që nxënësi të njihet me drogat e pasura me esenca - ilustrojë gjatë shpjegimit me pamje vizuale - debatojë me nxënësit duke punuar në grupe - përcjellë me kujdes argumentet e nxënësve gjatë shpjegimit. - realizojë vlerësim me shkrim dhe me gojë
d) Kushtet për realizimin e kapitullit:
<ul style="list-style-type: none"> - Vizatime dhe katalogje me bimë - CD-programe - Videoprojektorë - broshura këshilluese, herbarium, atlas botanikë
Kapitulli IV: Alkaloidet dhe drogat përkatëse
a) Qëllimet e kapitullit
<p>Në përfundim të kapitullit nxënësit duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruajnë përhapjen dhe grumbullimin e alkaloidëve në bimë; - Shpjegojnë rolin dhe përbërjen kimike të tyre; - Klasifikojë alkaloidët sipas përbërjes së tyre kimike; - Ilustrojnë skemën e ekstraktimit të alkaloidëve; - Përshkruajnë veprimin dhe përdorimin e alkaloidëve; - Dallojnë drogat me alkaloidë;
b) Temat e kapitullit
<ul style="list-style-type: none"> - Njohuri të përgjithshme për alkaloidet. - Përhapja dhe dinamika e grumbullimit të tyre në bimë. - Klasifikimi i alkaloidëve. - Ekstraktimi, pastrimi dhe ndarja e alkaloidëve. - Identifikimi dhe përcaktimi sasior i alkaloidëve.
c) Udhëzime didaktike për kapitullin
<p>Rekomandohet që mësuesi të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcjellë me kujdes avancimin e nxënësve; - nxitë aftësitë dalluese të nxënësve në punë me grupe; - vlerësojë nxënësit me detyra kontrolli; - organizojë vlerësim me gojë;
d) Kushtet për realizimin e kapitullit:
<ul style="list-style-type: none"> - Videoprojektorë - Cd-programe - Atlase të bimëve, foto nga interneti
Kapitulli V: Rrëshirat dhe drogat përkatëse
a) Qëllimi i kapitullit
<p>Në përfundim të kapitullit nxënësit duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruajnë përbërjen kimike, epërsitë dhe të metat e rrëshirave; - shpjegojnë metodat e nxjerrjes së rrëshirave; - përshkruajnë klasifikimin e rrëshirave; - dallojnë vetitë fizike të rrëshirave; - identifikojnë drogat rrëshira (droga vajore e pishës);

<ul style="list-style-type: none"> - përkufizojnë balsamet (Balsami i Perusë); - përshkruajnë metodat e përfitimit, nxjerrjes dhe përpunimit të balsameve;
b) Temat e kapitullit
<ul style="list-style-type: none"> - Njohuri të përgjithshme për rrëshirat (Resinae). - Metodat e nxjerrjes së rrëshirave. - Përbërja kimike dhe klasifikimi i rrëshirave. - Vetitë fizike dhe analiza e rrëshirave. - Rrëshirat vajore dhe rëndësia e tyre. - Përfitimi, nxjerrja dhe përpunimi i balsameve.
c) Udhëzime didaktike për kapitullin
<p>Rekomandohet që mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ilustrojë ligjëratat me shembuj të ndryshëm nga jeta e përditshme; - ilustrojë ligjëratat edhe me sllajde, dhe revista që kanë të bëjnë me bimët; - vlerësojë nxënësit me detyra kontrolli; - organizojë test me shkrim;
d) Kushtet për realizimin e kapitullit
<ul style="list-style-type: none"> - Videoprojektorë dhe foto nga interneti - CD-programe. - atlase bimore, vizatime dhe herbariume
Kapitulli VII: Saponinet dhe taninet
a) Qëllimi i kapitullit
<p>Në përfundim të kapitullit nxënësit duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasifikojnë dhe përshkruajnë saponinat dhe drogat përkatëse - Veprimi dhe përdorimi i drogave me saponina - Përkufizojnë dhe të tregojnë për përhapjen e tanineve - Vepimi dhe përdorimi i drogave me tanine
b) Temat e kapitullit
<ul style="list-style-type: none"> - Njohuri të përgjithshme për saponinat - Veprimi dhe përdorimi i drogave me saponina - Njohuri të përgjithshme për taninet - Veprimi dhe përdorimi i drogave me saponine
c) Udhëzime didaktike për kapitullin
<p>Rekomandohet që mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ilustrojë ligjëratat me shembuj të ndryshëm nga jeta e përditshme; - ilustrojë ligjëratat edhe me sllajde, dhe revista që kanë të bëjnë me bimët; - vlerësojë nxënësit me detyra kontrolli; - organizojë test me shkrim;
d) Kushtet për realizimin e kapitullit:
<ul style="list-style-type: none"> - Videoprojektorë dhe foto nga interneti - CD-programe. - atlase bimore, vizatime dhe herbariume